



Republika e Kosovës

Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Istog

Skupština Opštine Istok
Municipal Assembly Istog

Komiteti për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

Nr. 02	P r o c e s v e r b a l
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e Rregullt e KPF-së
Data e mbajtjes:	20.05.2022 në ora 10:00
Mbledhjen e kryesoi:	Enver Rugova, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Istogut
Procesmbajtës:	Vjosa Hysenaj, Zyrtare e Lartë për Punë Profesionale të Kuvendit të Komunës së Istogut
Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së	Hajrush Shoshi, Faruk Kabashi, Liridona Lajqi, Ajshe Metaj, Ardita Idrizaj dhe Niman Beqiraj
Mungojnë:	
Pjesëmarrës të tjerë:	Kryetari i Komunës Ilir Ferati, nënkryetari i Komunës Ali Nimanaj, Drejtorat: Merita Muzliaj Bytyçi, Elianë Blakaj, Agon Dreshaj, Dukagjin Hoxhaj, Zenel Shatri, naim Behluli, zyrtar Administrativ: Agim Ademaj, Jeta Balaj, Servete Haxhijaja, Alketa Bujupi Bytyçi, Flora Bujupi, OSCE Hysen Pelaj.
Rendi i ditës: 1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Komitetit, 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB-së) për vitin 2022, 4. Njoftimi me Raportin vjetor të punës të NPL. "Ambienti" për vitin 2021, 5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të ndarjeve buxhetore për tejkalimin e THV 2021, 6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga THV 2019,2020 dhe 2021, 7. Shqyrtimi dhe miratimi i Transferit nga Kategoria Ekonomike ,38-Rezerva në Kategorinë Ekonomike,30-Shpenzime Kapitale.	
Diskutimet:	
Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova, përshëndeti të pranishmit. Konstaton kuorumin 7 anëtar të KPF-së janë prezent, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e kësaj	

mbledhje.

Hapë punimet për këtë mbledhje me pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje.

Prezanton rendin e ditës,

Së pari dua tu kërkoj falje për problemet që kemi pasur me materialin, për shkak të volumit të madh të materialit. Materiali nuk ma mundur të ju vijë dhe raportet financiare nuk janë hapur sepse ka pasur probleme teknike.

Fton Ekzekutivin si dhe Anëtarët e KPF-së nëse dikush ka ndonjë pyetje sugjerim apo ndonjë propozim për rend dite?

Nimon Beqiraj, vërejtje për procesverbalin pyetja që kam bërë unë i ka humbur kuptimin,

Kryesuesi i Kuvendit – z. Nimon pasi të dalim të procesverbalit e jap vërejtjen tende.

Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati – përshëndet të gjithë të pranishmit, sqaron pikën e 7, sepse vendimet e përmbartimit po na pengoj me proceset e projekteve.

Ajshe Metaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, sa i përket projekteve të reja ka qenë rendi të dërgohet kur janë vendosur pikat jo sot se duhet të analizohet materiali.

Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati – materialin e kemi pasur, por sot e kemi pranuar materialin edhe me këto ndryshime për shkak të përmbartimeve.

Ajshe Metaj – shpesh na vijën anekse kështu me vonës mos të bëhet shprehje

Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova – krejt çka është në kuadër të ligjit po mundohemi ta bëjmë.

Hajrush Shoshi – pika e parë konstatimi i prezencës së anëtarëve pse kjo pikë kur me ligj është e parapara konstatimi pas çdo votimi.

Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova – po, ne edhe para çdo votimi e konstatojmë prezencën. Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës.

Kush është që të miratohet rendi i ditës.

Miratohet rendi i ditës me 5 vota për dhe 2 abstenime.

Prezent në mbledhje janë të gjithë anëtarët e Komitetit

Vendimet:

Miratohet me shumicë votash rendi i ditës, me këtë propozim nga Ekzekutivi.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 1.

Diskutimet:

Kryesuesi – Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit, Konstatoj që të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë e Financa janë prezentë në këtë mbledhje, dhe mund të fillojmë me pikat në

vazhdim.	
Vendimet:	
Vazhdojmë me mbledhjen	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Shqyrtimi i pikës 2.	
Diskutimet:	
Kryesuesi, vazhdojmë më pikën tjetër të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Procesverbali është kthyer ne transkript nuk po zbatohet Rregullorja e kuvendit ajo mbetet në arkiva ju lutem qe te kemi pak konsideratë nuk e kam ndjekur as një here rregullin. Te kemi parasysh se çdo gjë nuk shkruhet kështu, a ka dikush diçka? Nimon Beqiraj – Kryesues ne kemi qen bashkëpunues por edhe tani po jemi bashkëpunues ne po japim vërejtjet tona mos te humbim kuptimi fjalisë. Kam thënë pse ne po kemi kaq shume suficit dhe po detyrohemi, te varrezat e Vrelles besoj qe është rregulluar. Ajshe Metaj – ne në përgjithësi konceptet janë thelbi i çdo gjeje. Pyetje mandatin e kaluar a ka qen gabim ajo qe është përcjellë fjalimi i asamblistit. Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova – jo gabim por transkript vetëm parlamenti i Kosovës mbanë ne kemi vërejtje nga të gjithë që monitorojnë mbledhjet e Kuvendit. hedh në votim. Miratohet unanim miratohet procesverbali me vërejtje	
Vendimet:	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Shqyrtimi i pikës 3.	
Diskutimet:	
Kryesuesi i Kuvendit, vazhdojmë më pikën e tretë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB-së) për vitin 2022. Pasi që Koordinatori i KKSB –së, nuk është në mbledhjen e Komiteti për ta prezantuar Planin e punës së Këshillit Lokal për Siguri në Bashkës kjo pika e rendit te ditës shtyhet për mbledhjen e ardhshme. Kush është për, Hedh në votim Miratohet unanim që të shtyhet pika për mbledhjen e ardhshme	
Vendimet:	
Pasi që vërejte dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF –ja unanim shtyn për mbledhjen e ardhshme Planin e punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB-së) për vitin 2022	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 4.	
Kryesuesi i Kuvendit, vazhdojmë më pikën e katërt të rendit të ditës: Njoftimi me Raportin vjetor të punës të NPL. "Ambienti" për vitin 2021, Pasi që menaxheri i Ndërmarrjes Ambienti nuk është prezent, por tha se mund të vijën në mbledhje po e lemë këtë pikë për në fund. Hajrush Shoshi – pika të mbetet për në fund të mbledhjes.	
Diskutimet:	
Vendimet:	
Pasi që menaxheri i Ndërmarrjes Ambienti nuk është prezent, por tha se mund të vijën në mbledhje po e lemë këtë pikë për në fund të mbledhjes.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 5.	
Diskutimet:	
Kryesuesi i Kuvendit, po vazhdojmë më pikën e pestë të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të ndarjeve buxhetore për tejkalimin e THV 2021. Ftojme z. Osmon Sadikaj ta prezanton. Osmon Sadikaj – përshëndet te gjithë të pranishmit, bene prezantimin dhe sqarimin e propozimit të ndarjeve buxhetore për tejkalimin e THV 2021, Hajrush Shoshi – vërejtje , një gabim në shuma, Osmon sadikaj – po e vërtet por kjo është korrigjuar tash. Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova - Hedh në miratim: Propozimi i ndarjeve buxhetore për tejkalimin e THV 2021. Miratohet unanimit nga anëtarët e KPF-së.	
Vendimet:	
Pasi që vërejte dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanimit, ai kalon kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim propozimin e ndarjeve buxhetore për tejkalimin e THV 2021..	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 6.	
Kryesuesi i Kuvendit, vazhdojmë më pikën e gjashtë të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga THV 2019,2020 dhe 2021.	

Osmon Sadikaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, bene prezantimin dhe sqarimin e propozimit të bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga THV 2019,2020 dhe 2021.

Ajshe Metaj – projektet që po i mëre përmbartuesi po hyn në këto lista dhe projektet që janë këtu po duhet të hiqen , janë shkurtuar projekti në fshatin Saradran projekti i kanalizimit është shkëputur kam pritur që do të vendoset sivjet në nuk po e respektojmë rendësinë e projekteve prioritetin. I kom analizuar këto lidhur me këtë lidhur me projektet kapitale sigurisht edhe para këtij mandati I kom këqyr projektet kapitale ka shumë raste trotuari në Kalien është dëmtuar, a ka mbikëqyrje të projekteve mos të dështojnë.

Hajrush Shoshi – pagesat e përfituesit të shoqërisë civile i njëjti Projekt i njëjti por është me dy kode Sa i përket madhësisë dhe shërbimeve të patëm të institucionet shkollore 10 mijë euro nuk mund të shpenzojnë as një here, po transport mirë, por për mirëmbajtje të projekteve në shkollë nuk është dashur të jete as një cent sepse ka parë të mjaftueshme për mirëmbajtjen e projekteve nëpër shkollë. Drejtori duhet të planifikojë që sa më shpejt ta hapë këtë tender që të mirëmbajnë shkollat.

Drejtori i Bujqësisë, z. Astrit Hajrizaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, e-bujku çka ka menduar me këtë 35 mijë euro. A ka platformë dhe si do të duket.

Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova – I kisha dhënë përgjigje profesoreshës, një projekt i kanalizimit në fshatin Kashicë ka qenë projekti deri aty në kemi nda gropa që të përfshihet edhe ajo pjesë tani në bashkëpunim me drejtorin do të përfundojë edhe ajo pjesë. Trotuari në fshatin Kalien nuk është punuar mirë e kemi shkëputur kontratën me të kemi edhe disa punë që I ka bërë keq. Banoret i kanë dëmtuar me shumë por kompania është dënuar.

Drejtor për Zhvillim Ekonomik dhe Buxhet e Financa , z. Genc Ademaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, Te pjesa e mbikëqyrjes së projekteve kapitale, ka qenë një kompani e kontraktuar të cilës i ka skaduar kontrata këtë muaj tash jemi në fazën e inicimit të procedurave për kontraktimin e një kompanie për mbikëqyrjen e projekteve kapitale.

Te pjesa tjetër që e ceku Hajrushin ndarja e buxhetit pse? Arsyeja është se janë programe të ndryshme buxhetore të shpërndara nëpër drejtori , pjesa e parë është të administrata Zyra për barazi gjinore, dhe e dyta të pjesa e shëndetësisë që ka të bëjë dhe një kontratë me Caritas.

Te pjesa e Kulturës së bashku me drejtoreshën me kërkesat që i kemi për përkrahjen e klubeve sportive kulturore etj. është dashur ta shtojmë buxhetin për 10 mijë euro.

Komente këtu cekën vlera , Mungesa e buxhetit për instalimin e ngrohjes nuk është realizuar pagesa ende.

Projektet kapitale mbikëqyrja e projekteve do të jete Drejtori dhe zyrtaret përkatës së bashku me kompaninë,

E-bujku për shkak të transparencës me të madhe të bujqve kemi hartuar një projekt që të ndërtohet një ide për secilin fermer të komunës së Istogut. Me ju lehtësuar bujqve puna përmes kësaj platforme.

Ajshe Metaj – shumë mirë që po bëjnë të gjitha këto rregullsi, a është bërë ajo pranim i punës nga zyrtaret tonë a jo, sa here po e shohë punën aty po ndihet keq .

Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova - A ka edhe dikush diçka?
Pasi që nuk ka diskutime tjera, dhe në votim
Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së që propozimi për bartjen e mjeteve financiare te pa shpenzuara nga THV 2019,2020 dhe 2021, ti dërgohet Kuvendit shqyrtim dhe miratim.

Diskutimet:

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja rekomandon që: propozimi për bartjen e mjeteve financiare te pa shpenzuara nga THV 2019,2020 dhe 2021, t'ia kalohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i kuvendit, vazhdojmë më pikën e shtatë të rendit të ditës , Shqyrtimi dhe miratimi i Transferit nga Kategoria Ekonomike ,38-Rezerva ne Kategorinë Ekonomike,30-Shpenzime Kapitale.

Osmon Sadikaj - bene prezantimin dhe sqarimin e Transferit nga Kategoria Ekonomike ,38-Rezerva ne Kategorinë Ekonomike,30-Shpenzime Kapitale.

Niman Beqiraj - pyet a ka mundësi me u merr vesh me këta mësimdhënëse me ju dhen retroaktiv këto para mos me pas nevojë me i zvogëluar projektet.

Varrezat e reja ne fshatin Vrelle 55 mije euro është projekt që ka hy edhe një here nga fillim nuk mbulohet me këto mjete, po ashtu është edhe participimi qe e kanë bere qytetarët me 20% atëherë edhe kjo largohet sepse nuk e kanë me u përfshi se qysh janë na ka jep sqarimin Nënkryetari Nimanaj. Disa nga projektet e larguara kompletë janë ndërtimi i rrugës në lagjen Imeraj në Padalishta , pse nuk e bëni ju me mujt me dit se cili projekt ka me vazhduar mos me marr shumë kohë.

Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati – Niman premtimi edhe gjatë fushatës politike ka qenë qe ta paguajmë kontratën kolektive mësimdhënësve, që në momentin e parë me ndonjë marrëveshje që të mos hymë në detyrime të përmbaruesi, por këta kanë vazhduar dhe përmbaruesi po i merr mjetet, ende kemi me pas pasoja fatkeqësisht në buxhetin tonë.

Buxheti i varrezave nga viti 2021 është dyfishuar, por i ndarë ne dy faza për dy vite, është buxhet i dyfishuar.

Ajshe Metaj – u prek fusha e arsimtarëve, ne na vjen keq për projektet qe janë shkurtuar ose qe edhe janë eliminuar. Ke e kemi ngritur zërin boll që të planifikohen qe të paguhen kontrata kolektive, por njerëzit janë lodhur duke pritur dhe kanë vazhduar me procedurat.

Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati – nuk e pata qëllimin me i prek arsimtarët se kam respekt shume te madh, nuk po gjykoj atë është obligim dhe duhet me e krye ne edhe i kemi nda mjetet buxhetore për atë.

Ajshe Metaj – me marrëveshje është dashur te lahen ka pak ka pak borxhet, këto i kanë nënshkruar

qeveria Kryeministrit që kanë qenë, ne duhet ti aprovojmë

Genc Ademaj – kontrata kolektive në vetëm se kemi hyr në obligime në ke i hyr në obligim për këtë kontratë nga ministria nuk është planifikuar buxhet për kontratat kolektive, të drejtë me marrëveshje nuk kemi për ato pagesë atë kontratës.

Ardita Idrizaj – ndërtimi i varrezave në fshatin Lubozhdë është lokacioni i mëhershëm apo ka pasur ndonjë ndryshim dhe a e mbulon kjo shumë buxhetore.

Genc Ademaj – Lokacioni të memoriali i dëshmoreve është një sipërfaqe e madhe aty në kemi pasur bisedime me bidonët dhe do të bisedojmë prapë .

Liridona Lajqi Avdijaj – kërkesë tek përmendorja lagja Idriza Lubozhdë, vëllezërit Meshi dhe Idrizaj është e dëmtuar shumë, a ka mundësi ta mirëmbaj komuna .

Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati – në diskutim me drejtorin e agresioneve për mbrojtjen e monumenteve edhe bashkë me zyrtarin e prokurimit e kanë marrë përsipër mirëmbajtjen e përmendoreve në Istog.

Hajrush Shoshi – Në shtator të vitit të kaluar është aprovuar një buxhet ku kanë qenë edhe varrezat e fshatit Saradran ka qenë mirëmbajtja e varrezave në fshatin Saradran, aty nuk ka asnjë rrethojë Pse është anashkalim fshati Saradran janë varrezat të përmendoreve aty është një ndërrim jo i arsyeshëm.

Digjitalizimi i klasave nëpër shkollë aty janë blerë lloptopet, tv-të vitin e kaluar nuk ka kaluar dhe ka shkuar në fond rezervë, tash janë 30 mijë euro.

Janë edhe dy projekte të cilat janë aprovuar por ju kanë ndërruar emrat

Ndriçimi i aksit rrugor në Saradran.

Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati – një pjesë e mjeteve ka kaluar në rezervë për shkak të keqklasifikimit dhe një pjesë tjetër, përshkrimin e klasifikimit nuk e ka pranuar dhe kanë kaluar në rezervë.

Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova – ka pasur njerëz që kanë investuar me para të tyre

Nimon Beqiraj – Lagja Kadaj a u heqë krejt a veç 50%,

Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati – vetëm 50% janë hequr.

Osmon Sadikaj Sqaron , 1 milionë po mbesin, 400 mijë po hiqen.

Kryesuesi – hedh në votim unanim miratohet të shkojë KK shtatë anëtar presën.

Kryesuesi i Kuvendit – pasi që diskutime tjera nuk ka.

Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së, Transferit nga Kategoria Ekonomike ,38-Rezerva në Kategorinë Ekonomike,30-Shpenzime Kapitale

Vendimet:	
Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja rekomandon që: Transferit nga Kategoria Ekonomike ,38-Rezerva ne Kategorinë Ekonomike,30-Shpenzime Kapitale, i njëjti ti kalohet Kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 4.	
Diskutimet:	
Kryesuesi i Kuvendit, po vazhdojmë më pikën e katert të rendit të ditës, Njoftimi me Raportin vjetor të punës të NPL. "Ambienti" për vitin 2021,	
Alfredi Tahirsylaj, menaxher i "NPL Ambienti" – përshëndet të gjithë të pranishmit, benë prezantimin dhe sqarimin e Raportit vjetor të punës të NPL. "Ambienti" për vitin 2021.	
Ajshe Metaj – kjo ndërmarrje ka qen regjionale dhe përpjekjet tona kanë qen me be komunale, deri kur do te vazhdoj kjo kështu, kur do ti zgjidhet statusi kësaj ndërmarrje. Kjo ndërmarrje ka përfshirje mjaft te mire , te pajisen te gjitha me kontejner jo me thasë se po ndotet ambienti për shkak te qenve endacak se po i grisin, Pse GIZI1 nuk është realizuar krejt, ju si menaxher	
Alfredi Tahirsylaj, menaxher i "NPL Ambienti" – 80% e territorit te komunës së Istog është mire , jemi ne pritje qe temë und te i sigurojmë kontejner për te gjithë komunën , Nuk jam me ushtrues detyre por jam menaxher . Nuk jam ushtrues detyre por jam menaxher i "NPL Ambienti".	
Faruk Kabashi – jam i kënaqur qe janë hequr kontejnerët nga fshatrat se pse të gjithëve na pengojshin jam i kënaqur me punën e tyre.	
Ardita Idrizaj – deponit ilegale, a ka iniciative me i pastur p.sh në fshatrat Vrellë dhe Lubozhd rrugës për bjeshke po ka shumë mbeturina .	
Niman Beqiraj – parqet kam qen edhe vetë vullnetar disa here që e kemi pastruar parkun e Gurrakocit dhe mirëmbajtja e miniparkut nëse mund ti them të dëshmoret në qendër të Vrelles aty është prej rrethit deri të shkolla ndërsa sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve vetëm një vere e kam par një punëtor të ambientit duke i pastruar rrugët jo ma shumë. Raporti është i varfër 7 faqe për një vit është pak	
Alfredi Tahirsylaj, menaxher i "NPL Ambienti"– Vrella pothuajse pastrohet 2 here ne javë, edhe kjo hyn jashtë pagesës.	
Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova – parqet po mirëmbahen mire , as një here nuk kanë qen ashtu.	
Abedin Kabashi – për momentin nuk kemi kontratë për heqjen e mbeturinave inerte, besoj deri ka korriku del tenderi dhe vazhdojmë ka shume mbeturina Inerte.	

Tenderi për bust stacionet do te del tani,

Te lagja Kadaj, aty ngjit është lagja Osmanaj shqetësimet e lagjeve mes veti mos po mujmë me i kyç,

Faruk Kabashi – pyetje , a kish pas mundësi në qendrat ma te mëdha te komunës me e pas çdo dit nga një punëtor .

Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova – pasi qe diskutime tjera nuk ka, a jeni qe kjo pikë ti shkoj Kuvendit

Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së.

Vendimet:

Pasi që vërejte dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF –ja unanim, ai kalon Kuvendit të Komunës Njoftimi me Raportin vjetor të punës të NPL. "Ambienti" për vitin 2021.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Kryesuesi i kuvendit, pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.

Shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoj : 12:22

Procesmbajtëse,
Znj. Vjosa Hysenaj



Kryesuesi i Kuvendit,
z. Enver Rugova